



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 52

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DREJTORIË SË
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, PËR PERIUDHËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBEKT: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 21.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 13.00, vendndodhja “Jashtë vendit”, “Manchester”, tematika “*Vizitë studimore nga data 21-25.01.2025. Në këto ditë do të zhvillohen konferenca për sistemin e burgjeve.* Nga Shqipëria

Data: 31.1.2025 Nr: 52
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

janë në këtë vizitë 20 përfaqësues, ndërsa në Manchester do të jenë drejtues të sistemit korrektues në Angli”.

- Në datën 25.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 25.1.2025, ora 10.00, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “Në Lezhë, Sindikata e Policëve të Burgjeve kanë zhvilluar mbledhjen periodike, ku ka qenë i ftuar edhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve z. Klevis Qose. Në takim janë diskutuar problemet në sistemin e burgjeve”.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka dërguar pretendimet vetëm për aktivitetin me tematikë “Tryezë diskutimesh”, duke sqaruar se: “Aktiviteti i zhvilluar në qytetin e Lezhës. Në këtë takim, ku i ftuar ishte edhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, z. Klevis Qose, u mbajtën diskutime mbi mbarëvajtjen dhe disa pakënaqësi në punë”.

Në përfundim të shqyrtimit, konstatohet se në të 2 (dy) aktivitetet e raportuara, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka qenë në cilësinë e të ftuarit.

Referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, veprimtaritë ku institucioni publik apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë, nuk mbartin detyrimin për raportim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI